



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.6.	RREZIQET QË LIDHEN ME AKSIDENTET NË PUNË
Nën-tema 2.6.5.	PUNIMET TOKËSORE
Ligji / rregulloret përkatëse:	<ul style="list-style-type: none">• Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë;• Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë;• Rregullore (MPMS) Nr.06/2017 për kriteret minimale të sigurisë dhe shëndetit në vend ndërtimet të përkohshme apo mobile;• Rregullore (MPMS) Nr.01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.
Shkurtesa:	• MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Fushëveprimi i listës kontrolluese:	Kjo listë kontrolluese është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushëveprimin e zbatimit të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe bazat mbi të cilat kryhen puna ose trajnimi në vendet e punës ku ka punime tokësore (gërmime).
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	INSPEKTIMI I VENDIT TË PUNËS ME PUNIME TOKËSORE (GËRMIME)			
	<ul style="list-style-type: none">* Bëhuni shembull; respektoni rregulloret e sigurisë dhe shëndetit në lokacionin / vendet e punës të inspektuara!* Gjatë vizitës në lokacion/vendin e punës kushtoni vëmendje aspekteve të përgjithshme ose organizimit të punës dhe proceseve, duke përfshirë mjedisin rrethues dhe faktorët që mund të kenë efekt mbi punëtorët ose publikun e përgjithshëm.* Merrni shënime për vendet e vëzhguara të punës dhe bëni fotografi të rrethinës (kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë).* Mbani mend:			

	<ul style="list-style-type: none"> ○ pyesni disa prej të punësuarve në lidhje me informacionin e tyre në lidhje me rreziqet dhe masat parandaluese gjatë punimeve tokësore * Nëse keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspertin tuaj për SSHP, takohuni me të/ata; * Ftoni përfaqësuesin e të punësuarve të marrë pjesë në kontrollimin e dokumenteve. 			
1.	<p>A është kryer vlerësimi i përgjithshëm i riskut për punime tokësore/gërmime?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Është obligim i juaji të ofroni vlerësimin e riskut - kontrolloni nëse është kryer dhe dokumentuar.</i> ● <i>Kontrolloni nëse vlerësimi i riskut përmban analiza të rreziqeve që lidhen posaçërisht me punimet tokësore, duke përfshirë të gjitha detyrat e punës gjatë punimeve tokësore (p.sh., përgatitja e zonës, vendosja e rrethojave, gërmimi i llogoreve, puna në llogore etj.).</i> ● <i>Kontrolloni nëse janë marrë masat e nevojshme për t'i shmangur ose zvogëluar këto risqe (p.sh. masat e marra organizative ose teknike).</i> ● <i>Kontrolloni nëse janë vlerësuar posaçërisht risqet për punë nën 1.5 m thellësi.</i> 			
2.	<p>A është siguruar kontrolli për secilin vend të punës të veçantë për punime tokësore (për secilën vend të punës)?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16 Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse një person kompetent (i caktuar nga ju) ka kryer një inspektim të dokumentuar të vend të punës para fillimit të punës, duke mbuluar të paktën:</i> <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>natyrën e gërmimit të planifikuar dhe punimeve të planifikuara;</i> ○ <i>kushtet e tokës dhe dherave brenda dhe rreth gërmimit, duke përfshirë nivelet e ujit;</i> ○ <i>mjetet e planifikuara të hyrjes dhe daljes nga gërmimi;</i> 			

	<ul style="list-style-type: none"> ○ raportet nga inxhinieri gjeo-teknologjik që detajojnë kushtet në zonën e planifikuar të gërmimeve; ○ zonat dhe mjetet e planifikuara të hyrjes dhe daljes nga gërmimi; ○ strukturat e afërta dhe strukturat e sipërme (p.sh., linjat elektrike) që mund të ndikohen nga punimet tokësore. ● Kontrolloni nëse ka <u>dokumentacion të shkruar</u> në lidhje me rrjetet ekzistuese të komunikimit në zonën e planifikuar të punimeve tokësore (p.sh., kabllot e energjisë elektrike, linjat e gazit, gypat e ujit etj.). 			
3.	<p>A është ofruar informacion dhe trajnim i mjaftueshëm për të punësuarit në lidhje me rrezikun gjatë punimeve tokësore dhe masat e mundshme parandaluese?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Nenet 7, 9, 13, 20 Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> ● A ka informacion (të shkruar) në dispozicion dhe të ofruar për të punësuarit (p.sh. materiale, trajnimi, broshura/postera)? ● Kontrolloni nëse informacioni specifik për trajnim (nëse aplikohet) përfshin: <ul style="list-style-type: none"> ○ rreziqet specifike për punimet tokësore, kërkesat për hyrje dhe dalje të sigurt, metodat specifike të instalimit, procedurat e emergjencës dhe shpëtimin, metodat e komunikimit me operatorët e makinerive etj. ● Kontrolloni nëse është ofruar trajnim formal për të punësuarit, duke përfshirë trajnimin specifik për operatorët e makinerive? ● A është përsëritur periodikisht sipas kërkesave ligjore dhe/ose në rastet kur kanë ndryshuar vendet e punës ose procedurat? 			
4.	<p>A ka pasur konsultime me punësuarit (dhe përfaqësuesit e tyre) në lidhje me punimet tokësore?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 19</p> <ul style="list-style-type: none"> ● A kanë qenë të përfshirë të punësuarit (dhe/ose përfaqësuesit e tyre) në vlerësimin e riskut gjatë punimeve tokësore dhe planifikimin e masave 			

	<i>parandaluese (p.sh. politikat organizative, planifikimi i punës, trajnimet për të punësuarit, konsultimet etj.)</i>			
5.	<p>A përcaktohen dhe sigurohen orare të rregulla të mirëmbajtjes për pajisjet e gërmimit dhe pajisjet e sigurisë?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 5 Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV, V</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Është obligim i juaji të siguroni kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës në të gjitha aspektet e punës.</i> ● <i>Kontrolloni nëse oraret e mirëmbajtjes përfshijnë kontrole teknike të rregullta dhe në kohë për të gjitha automjetet/makineritë dhe pajisjet e sigurisë së llogoreve/gërmimeve sipas planit të prodhuesit (p.sh., kontrolli i frenave, dritave, bulonave, stabilitetit strukturor, komponentëve të sistemit të mbështetjes, mbajtësve të llogoreve etj.).</i> ● <i>Kontrolloni nëse këta kalendarë përfshijnë kontrollin e tipareve të sigurisë së automjeteve (p.sh., dritat e frenave, rripat e sigurisë, strukturat mbrojtëse ndaj përmbysjes, strukturat mbrojtëse nga objektet që bien, frenat stacionare etj.).</i> 			
6.	<p>A sigurohen kontrole të rregullta në lidhje me sigurinë e gërmimit dhe a mbahen shënime?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse është siguruar sistemi i duhur i kontrollit për të siguruar që çdo zonë e punimeve tokësore të kontrollohet të paktën një herë në ditë (dhe para çdo ndërrimi për llogore me më shumë se 2m thellësi).</i> ● <i>Kontrolloni nëse mbahen shënime për këto kontrole (përfshirë datën e kontrollit (dhe orën), rezultatit e kontrollit dhe nënshkrimin e personave përgjegjës).</i> 			
MBIKËQYRJA E LOKACIONIT / VENDIT TË PUNËS				
7.	<p>A janë marrë masat e nevojshme të sigurisë për të siguruar stabilitetin e gërmimit?</p>			

	<p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse është siguruar që pjerrësitë anësore të gërmimeve janë të siguruara siç duhet me materiale të përshtatshme (p.sh., mbështetja e llogores me forcë dhe qëndrueshmëri të mjaftueshme pa defekte të dukshme) ose të dizajnuara siç duhet (p.sh., përdorimi i shkallëzimeve dhe ngjeshjeve).</i> ● <i>Kontrolloni nëse strukturat e mbështetjes së llogores janë ngritur nga punëtorë të aftë në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.</i> ● <i>Kontrolloni nëse sigurohet mbështetja e llogores (të paktën 20 cm më e lartë se skaji i sipërm i gërmimit) për gërmime më të thella se 120cm.</i> 			
8.	<p>A sigurohen rrugë të sigurta të hyrjes/daljes në gërmim?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse sigurohen rrugët e sigurta të hyrjes/daljes brenda dhe jashtë gërmimeve (p.sh., shkallët e gjatësisë së duhur etj.).</i> ● <i>Kontrolloni nëse rrugët ekzistuese të hyrjes/daljes u lejojnë punëtorëve të shpëtojnë nga emergjencat (p.sh. rrjedha e ujit etj.).</i> 			
9.	<p>A sigurohet ventilim i mjaftueshëm ose furnizim me ajër në të gjitha zonat e punës kur punohet gjatë gërmimit?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse është siguruar ventilimi i mjaftueshëm ose furnizim me ajër nëse është e nevojshme, për të siguruar atmosferë të frymëmarrjes.</i> ● <i>Kontrolloni që, nëse është e nevojshme, ekzistojnë mjete të përshtatshme për të zbuluar nëse ka ekspozime potencialisht të rrezikshme ose të dëmshme në gërmime (p.sh. rrjedhje të gazit etj.).</i> 			
10.	<p>A është siguruar që parmakët (rrethojat) e rrethojnë gërmimin?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse gërmimet janë të rrethuara nga parmakë mbrojtës (të paktën 0.9m të lartë).</i> 			

	<ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse merren masa të tjera nëse është e nevojshme, për të parandaluar që punëtorët ose kalimtarët të bien në llogore.</i> 			
11.	<p>A janë siguruar vendkalime të sigurt gjatë gjurmimit?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse rrugët e kalimit janë siguruar për llogore me thellësi më shumë se 0.5m - me gjerësi minimale prej 0.75m (ose 1.5m - për rrugët e kalimit në dispozicion të publikut).</i> ● <i>Kontrolloni nëse rrugët e kalimit për llogore me thellësi më të vogël se 1.5m janë të pajisura me parrakë në të dy anët me lartësi minimale prej të paktën 0.9m (duhet të sigurohen parrakë me shufër të dyfishtë me fund mbrojtës për rrugët e kalimit në dispozicion të publikut).</i> ● <i>Kontrolloni nëse rrugët e kalimit për llogore me thellësi më shumë se 1.5m janë të pajisura me shufër të dyfishtë me fund mbrojtës me lartësi minimale prej të paktën 0.9m.</i> 			
12.	<p>A ruhen si duhet pajisjet dhe materialet e përdorura pranë gjurmimit?</p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse pajisjet (p.sh. traktorët, pajisjet e saldimit etj.) nuk ruhen afër shpateve të gjurmimeve.</i> ● <i>Kontrolloni nëse materialet (p.sh. gypat, kabllot, etj.) nuk ruhen afër shpateve të gjurmimeve dhe nëse është e ndaluar posaçërisht.</i> 			
13.	<p>A ka ndriçim të mjaftueshëm në zonat e punës të gjurmimit?</p> <p>Rregullore (MPMS) 01/2020 Tabela 3</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse të gjitha zonat e punës në gjurmime kanë nivele të mjaftueshme të ndriçimit (qoftë natyral dhe/ose artificial) dhe sistemet e ndriçimit mbahen në rregull.</i> ● <i>Kontrolloni nëse ka sistem ndriçimi emergjent (rezervë) dhe nëse është testuar dhe mirëmbajtur.</i> 			

14.	<p>A ka një numër të mjaftueshëm të shenjave paralajmëruese të vendosura në zonat ku ato mund të shihen qartë?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse zonat e punimeve tokësore ku rëniet në llogore janë të mundshme janë të shënuara qartë (duken nga distanca kur afroheni, në lartësinë e duhur) me shenjat “Rrezik Rënie”.</i> <div data-bbox="775 453 913 576" data-label="Image"> </div> <p>“Rënie”</p>			
15.	<p>A ka numër të mjaftueshëm të shenjave paralajmëruese të vendosura për të informuar publikun dhe a janë të rrethuara siç duhet vendet e punës të punimeve tokësore?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <i>Kontrolloni nëse zonat e punimeve tokësore është e rrethuar siç duhet me rrethojë të lartë të paktën 2m.</i> ● <i>Kontrolloni nëse rrethoja është e pajisur me dritë paralajmëruese të vendit të punës jo më larg se 50 metra larg nëse është vendosur përgjatë rrugës.</i> ● <i>Kontrolloni nëse shenjat paralajmëruese “Ndalohet qasja për këmbësorë” janë vendosur në zona ku mund të shihen qartë.</i> <div data-bbox="779 1091 904 1214" data-label="Image"> </div> <p>“Ndalohet qasja për këmbësorë”</p>			